

Viti XIII, numri 8/gusht 2009

FOREVER



HUNGARY / ALBANIA / BOSNIA AND HERZEGOVINA / CROATIA / MONTENEGRO / SERBIA / SLOVENIA



Gidófalvi Attila & Attiláné

new diamond-sapphire
managers





Kushtoji kohë verës!

Jemi në verë, dhe ky është një sezon shumë aktiv. Më pëlqen shumë kjo periudhë e vitit! Bari është i gjelbër, zogjtë këndojnë dhe qielli ka ngjyrë të mrekullueshme blu. Kur mendoj rreth verës më vijnë në mend fishekzjarret, akullorja e bërë vetë dhe thërritjet e gëzuara të fëmijëve.

Në Home Office përgatitemi me vull të plotë për Super Rally-n. Ndihen emocionet dhe u përshpejtua ritmi edhe në punën e përditshme. Bashkëpunonjësit e mi punojnë shumë që Rally të jetë një ngjarje interesante dhe e paharrueshme për gjithë pjesëmarrësit. Çdo vit punojmë në mënyrë të palodhur për ta bërë Rally-n më të madh e më të mirë se ai i vitit të kaluar. Dëshirojmë të jetë për të gjithë ju një aventurë vendimtare. Takimi i njerëzve të mbledhur nga pjesë të ndryshme të botës, të cilët bashkohen në interes të një qëllimi, është një mbresë që s'keni për ta harruar kurrë. Pastaj merrni me vete në shtëpi energjinë dhe entuziazmin që ta ndani edhe me të tjerët mundësinë e mrekullueshme të Forever-it.

Rally është ngjarja kur prezantojmë produktet tona të reja. Ju premtojmë që edhe sivjet do t'ju prezantojmë disa produkte interesante e të shkëlqyera. Doni të dini se cilat janë këto? Tani s'mund t'ua tregoj, por ejani në Dallas dhe jini të parët që dëgjoni rreth këtyre produkteve. Jam i sigurt se keni për t'i pëlqyer të rejtat tona!

Gjatë Rally-t të sivjetshëm do të keni mundësi të vizitoni Aloe Vera of America (AVA), fabrikën tonë të Dallasit. Njerëzit që punojnë aty me drejtimin Chris Hardy-t mezi presin t'ju prezantojnë fabrikën dhe mënyrën e prodhimit të produkteve. Pastaj bashkohuni me ne në një ekskursion me një atmosferë fantastike në Southfork Ranch. Organizojmë një party të shkëlqyer për ju dhe jam i sigurt që do ta ndjeni shumë mirë veten.

Por pavarësisht nga detyrat e verës, mos harroni t'i kushtoni kohë vetvetes dhe njerëzve që jetojnë rreth jush. Sa kohë kaloni me ta? Ua lehtësoni ngarkesat? U sillni buzëqeshje në fytyrë atyre me të cilët kontaktoheni? S'është kurrë vonë të veproni në mënyrë pozitive mbi botën dhe njerëzit që doni. Të jeni të sigurt se njerëzit që ju rrethojnë e ndjejnë dhe e dinë se mund të mbështeten tek ju. Mos e kurseni kohën për t'u bërë të ditur se sa të rëndësishëm janë për ju. Jepini këtë plus vetvetes dhe jam i sigurt se do ta merrni shumëfish prapa.

Shijoni kohën e mbetur nga vera – shikoni fishekzjarret, hani akullore, dëgjoni këngën e zogjve dhe kushtojuni vëmendje të dashurve tuaj. Takohemi në Dallas!

Rex Maughan

Drejt Amerikës



Në jetën e shumë njerëzve udhëtimi ka shumë rëndësi, familja përgatitet për ditë të tëra, sepse më në fund erdhi momenti i shumëpritur i pushimeve të verës. Të gjithë e masin të shqetësuar valixhen që të mos e kalojnë kufirin e peshës nëse udhëtojnë me avion. Ndjekin me vëmendje shfaqjen e motit, dhe natyrisht shqetësohen gjithmonë e më shumë me afrimin e ditës së nisjes. Për atë që nisët për herë të parë në udhëtim matanë oqeanit këto ndjenja janë edhe më të mëdha, mezi pret të nisët!

Dalëngadalë një ndjenjë e ngjashme pushton edhe afërsisht 200 punonjësit tanë me të cilët përgatitemi të emocionuar për Super Rally-n e Forever International të 2009-ës në Dallas. Drejtori ynë i përgjithshëm Rex Maughan na pret me programe të mrekullueshme. Si vend organizimi të Rally-t drejtoresha jonë Navaz Ghaswala ka gjetur një vend të shkëlqyer (http://www.foreverrally.com/2009SuperRally/2009_Super_Rally/videos/GaylordResot/OPEN.html), dhe natyrisht aty do të jetë edhe zëvendësuesi ynë Gregg Maughan dhe drejtori i Europës Aidan O'Hare, të cilët vijnë në Rally nga një program sensacional ndërtimi skuadre, Eagle Summit, drejtpërdrejt nga Republika Dominikane. Tregoj me kënaqësi se në këtë skuadër do të jenë edhe dy distributor drejtues hungarez: Safir Menaxheri Jozsef Szabo dhe Diamant-Safir Menaxheri Miklos Berkics.

Që si vjen ky udhëtim? Sa duhet të paguajmë në kasën e kompanisë për të shkuar në pikën më sensacionale të Teksasit? As nuk duhet t'i hapim portofolat tanë, nuk duhet të mbledhim një vit të tërë për biletën e avionit. Nuk duhet të merremi me faktin që a e përballojmë dot hotelin me 3 apo 4 yje. Këtu gjithçka na paguhet nga Forever Living, dhe gjithçka e marrim në nivelin më të lartë, hotelin me pesë yje, shërbimin me nivel të lartë, mësimin disa ditë, trainimin, vizitën e qendrës më të madhe Aloe Vera të botës, kalimin e portave të Sothfork Ranch me famë botërore, e marrim të gjithë këtë. Kompania pret vetëm një gjë nga ne, të bëjmë çdo ditë detyrën tonë, të ndajmë mundësinë e Forever-it me sa më shumë punonjës, blerës, dhe nëse e kryejmë në mënyrë korrekte dhe me ndershmëri këtë punë, atëherë albumi i fotove familjare mund të zgjerohet edhe me një udhëtim të tillë biznesi, sepse natyrisht do të ketë banket, argëtim, njohje me kolegë të ardhur nga gjithë vendet e botës.

Uroj që ata që tani lexojnë për herë të parë në jetë rreth kësaj mundësie të bashkohen sa më shpejt me këtë skuadër e cila tani përfaqëson rajonin tonë. Të ngremë lart në skenë flamurin e vendit tonë, të këndojmë muzikën e tij dhe të gëzohemi së bashku që i përkasim një skuadre të madhe e të fuqishme, skuadrës së Forever-it. U uroj të gjithëve kalim të mirë kohe, pushime të mbara dhe mësim të shumtë.

Përpara FLP Hungari!

DR. SANDOR MILESZ
drejtor gjeneral

T'ia tregojmë botës!



Të pranishmit u argëtuan nga paroditë e luajtura në mënyrë të shkëlqyer nga humoristi i ri **Peter Sas**.

Arena ra në heshtje kur zëri i Forever-it (**Dr. Adolf L. Kosa**) prezantoi drejtuesit e aktivitetit, çiftin senior menaxher **Orsolya Lenko Lopiczne**

dhe **Tibor Lopicz**, të cilët e ndërtojnë prej gjashtë vitesh rretin e tyre.

Në përshëndetjen e tij drejtori gjeneral **Dr. Sandor Milesz** i përforcoi të gjithë në faktin se ai që vepron me vendosmëri për realizimin e qëllimeve të tij, do të ketë

sukses edhe në këtë biznes. Meqë ne jemi më të mirët – në aspektin e qarkullimit për një person – atëherë t'ia tregojmë këtë edhe botës, nxiti pjesëmarrësit. Si pikësypnim të afërt bëri të njohur programin e Holiday Rally-t të Poreçit..

Dr. Csaba Gothard kësaj radhe tregoi shqetësimet e specialistit që merret me fiziologjinë e vitaminave dhe lëndëve minerale. Foli rreth rezultateve të një studimi që tregon prishjen e cilësisë së produkteve vendase. Konkluzioni i tij





është domosdoshmëria e plotësuesve ushqimor të pastër që vijnë nga burime të besueshme në ruajtjen e shëndetit.

Senior menaxherja **Dr. Ibo-lya Bagoly** duke përhapur mendimin e saj na tregoi ndërlidhjet e ngushta, por të qarta për pak njerëz, mes


shëndetit dhe mënyrës së jetesës. Leksionin e mbylli me përkufizimin e misionit të saj në Forever: me uljen e numrit të sëmundjeve jepi njerëzve mundësinë për një jetë të mirë.

Referatat e përvojave me produkte që na japin shumë rekomandime dhe këshilla me vlerë kësaj radhe u

drejtuan nga menaxherja **Dr. Eva Doczy**.

Pas kësaj supervizorët dhe asistent menaxherët e sapokualifikuar morrën në skenë medaljet tyre nga Dr. Sandor Miliesz të shoqëruar nga përgëzimet dhe brohoritjet e sponsorëve dhe miqve të tyre.







Senior menaxheri **Imre Mate-Kiss** foli rreth ndërtimit të suksesshëm të biznesit. Prezantoi kushtet dhe mundësitë e anëtarësisë së Business Builders. Me përvojën e tij shtatë vjeçare si rrjetndërtues dhe drejtues prezantoi mjetin më të rëndësishëm të suksesit: besueshmërinë. Me luajtjen e dy filmave të shkurtër e bëri edhe më të paharrueshëm leksionin e tij.

Gjatë vlerësimit të Klubit të Sundimtarëve, menaxherëve dhe menaxherëve drejtues në skenë u thirr **Attila** dhe **Katalin Gidofalvi** të cilët pranë medaljes së tyre të

diamant-safirrit merituan edhe medaljen "rrjetndërtuesi më i shpejtë i botës"

Senior menaxherja **Klara Hertelendy** e quajti FLP-n si një dhuratë që morri nga sponsori i saj. Sipas saj vlerat e FLP-s – puna, njohuria, ndershmëria – e mësoi të përparoj duke fituar dhe të ketë pikësnyime gjithmonë e më të larta.

Pas leksioneve të shkëlqyera profesionale u argëtua me këngët e njohura të shfaqura nga artistët **Piroska Pandi** dhe **Geza Egyhazi**. Meloditë e bukura që të ngrohnin zemrën ngritën në







kërcim shumë çifte në sheshin para skenës. Diamant-safir menaxheri **Robert Varga** morri mikrofonin me leksionin mbyllës të ditës. Me stilin e tij individual dhe përkushtimin e gjithë krijesës së tij u dha dëgjuesve një guxim karizmatik. E përktheu në gjuhën e përditshme formulën e suksesit: çdo javë një njeri të ri. Leksioni i tij u ofroi shumë njerëzve pikpamje të tjera për të ardhmen!

Dita e Suksesit përfundoi me kualifikimin e **asistent supervisorëve**. Në skenë u radhit një turmë prej mijëra vetësh, ku me krenari, gëzim dhe emocione morrën vlerësimin e parë të jetës së tyre.

Senior menaxherët **Olga** dhe **Miodrag Ugrenović** u treguan drejtues programi mikpritës dhe me njohuri të shkëlqyera kërcimtare. Rrjetndërtues të shkëlqyer të cilët bashkë me skuadrën e tyre punojnë në radhët e FLP-s për realizimin e qëllimeve të reja. I falenderojmë për drejtimin e përsosur të programit dhe u urojmë suksese të shumta në punë atyre dhe gjithë skuadrës së tyre.

Drejtuasi tjetër i aktivitetit tonë ishte drejtori rajonal i FLP

Serbisë **Branislav Rajić**. Zoti Rajić na kujtoi ngjarjet e muajit të kaluar. Aktivitetet, planet dhe mundësitë e shumta të punës që FLP ofron me programet e saj motivuese, kur për të njëjtën veprimtari mund të marrim më shumë shpërblime. Shpresojmë se programet motivuese i nxisin punonjësit tanë për punë më të madhe, sepse gjatë tyre me pak më shumë përpjekje mund të fitojnë gjëra me vlerë.

Ishte një nder i madh për ne që na erdhi si mysafir drejtori

operativ i FLP-s së Europës, **Peter Lenkey**. FLP është një lojë e cila përbëhet nga punë e madhe dhe argëtim i mrekullueshëm në një kompani ku buzëqeshja bën mrekulli dhe puna e vullnetshme jep gjithmonë rezultat. Vizioni i krijuesit dhe drejtuesit të përgjithshëm Rex Maughan është që çdo ëndërr të na bëhet realitet. E falenderojmë zotin Lenkey për pjesëmarrjen në aktivitetin tonë pavarësisht nga detyrat e tij të shumta. E dëgjuam me kënaqësi që tek


ne e ndjen veten si në shtëpinë e vet dhe e sigurojmë se në Serbi e presim me shumë kënaqësi edhe në të ardhmen.

Mes shumë programeve motivuese është edhe Rally European, takimi i distributorëve më të mirë të gjithë Europës. Safir menaxherët **Marija dhe Boško Buruš** janë mjeshtër të vërtetë të punës sonë. Ata treguan në mënyrë të hollësishme rreth recetës me të cilën mund të realizohen me efektivitet kushtet e këtij programi motivues. Puna në

Një kompani ku buzëqeshja bën mrekulli



Aktiviteti Success Day i parë i verës së Beogradit kaloi në një atmosferë të shkëlqyer. Jemi të sigurt se me sasinë e madhe të energjisë pozitive të çliruar këtu mund të arrijmë suksese të reja në Forever.



skadër ka gjithmonë rezultat, kurse FLP jep më shumë shpërblime për të njëjtën veprimtari të suksesshme.

Lëkura është organi më i madh i trupit tonë në trajtimin e përditshëm të të cilës produktet FLP, falë përbërësve të tyre të dobishëm luajnë një rol të rëndësishëm. Leksioni i mjekes së lëkurës **Dr. Mirjana Nedić** bazohet në përvojat e pasura të saj profesionale. Në leksionin me shumë ilustrime vërtetoi se përbërësit ushqyes të Aloe-s e risjellin ekuilibrin e lëkundur të shëndetit të lëkurës.

Punonjësit dhe distributorët ndanë me publikun përvojat e tyre me produkte, kurse punonjësit tanë mjek na treguan të dhëna të reja. Specialisti i shkëlqyer dhe eksperti i përpunimit të produkteve **Dr. Božidar Kaurinović** e drejtoi me mjeshtri këtë pjesë të programit, dhe me komentin e tij i plotësoi këshillat rreth përdorimit të produkteve.

Në skenën e Pallatit të Sindikatave u dhamë medaljet e merituarra supervizorëve të rinj dhe u uruam atyre fat dhe suksese të shumta në punë.

Luis është mjeshtri i argëtimit i krijimit të atmosferës së mirë. Me grupin e tij të plotësuar me disa këngëtarë organizoi një mbrëmje të madhe me të cilën e nxehi edhe më shumë atmosferën e mirë. E

falenderojmë shumë artistin e shkëlqyer dhe shpresojmë që edhe në të ardhmen të na argëtojë në aktivitetet tona.

„Do të doja që skuadra ime të jetë e suksesshme, prandaj i tregova shembullin tim.” – tha në leksionin e saj menaxherja **Ivona Tintar**. Ivona e arriti pikësyzimin e saj, sepse skuadra e realizoi dëshirën që kishte. Me punë të vullnetshme, organizimin e takimeve dhe prezantimeve të shumta, thirrje telefonike dhe punë në skuadër kjo kolegja jonë e re që në moshën njëzet vjeç shijon një pavarësi të madhe pune.

„Duhet të marrim vendimin që varet vetëm nga ne. Ne përgjigjemi për suksesin e

arritur me veprimtari të bazuar në vendimet e mençura. Aftësia me të cilën mund përcaktojmë pikësyzimet tona e lehtëson këtë proces.” – tha në leksionin e saj menaxherja **Marica Kalajdžić**. Marica premtoi që do ta vazhdojë rrugën drejt suksesit, sepse i zbaton parimet e punës, realizon ëndrrat e saj, dhe kështu kjo do të jetë FOREVER.

Sekreti i forcës dhe mundësisë së madhe të FLP-s fshihet tek distributorët dhe asistent supervizorët. Në kompaninë tonë mbjellim farat dhe besojmë se nga ato do të rritet një bimë e mrekullueshme me produkte të pasura – bashkëpunonjësi

– i cili pastaj në mënyrë të pavarur, duke zbatuar këshillat e sponsorit e vazhdon veprimtarinë marketing. Senior menaxherja **Mirjana Mičić** theksoi se përpara ndërtimit të punës sonë frika përbën pengesën më të madhe, por ajo mund të mposhtet me veprimtari të përditshme.

Ndjenjat janë forcat tona lëvizëse të brendshme dhe përbëjnë një burim bazë forcash edhe për ndërtimin e punës sonë. Në FLP gjë e mrekullueshme është që rezultati i arritur vlerësohet dhe shpërblehet menjëherë. Menaxheri **Zoran Ocokoljić** për gjithë jetën ia di për nder sponsorit të tij, sepse





ai vendosi ta ndryshojë jetën e Zoran-it. Të gjithë mund të ndryshojmë atë që duam – në interes të arritjes së qëllimeve tona.

Asistent supervisorëve të rinj u uruam suksese të shumta në punë dhe i përgëzuar për nivelin më të rëndësishëm të kualifikimit në FLP, i cili u ofron atyre mundësi për sponsorizimin e punonjësve të rinj.

Aktivitetin Success Day të ardhshëm e organizojmë më 19 shtator në Pallatin e Sindikatave të Beogradit.

BRANISLAV RAJIĆ
Drejtori rajonal i FLP Serbisë

Koha është një pasuri me shumë vlerë. Ajo është e paktë për ata që luftojnë për sukses. Sot do të flasim vetëm për ata! Të gjithë ata që e shfrytëzojnë me mençuri kohën e tyre fitojnë një jetë të pasur dhe produktive. Prandaj një nga mësimet bazë bën fjalë rreth shfrytëzimit të kohës. Është shumë e rëndësishme të dini si ta përdorni kohën. Të gjithë kemi njëllorj 24 orë në ditë: as një minutë më shumë e as më pak. Ekziston një ndarje kohe e zakoshme:

8 orët e para ia kushtojmë gjumit. Të dashur distributorë, shfrytëzoheni me përgjegjësi këtë kohë, sepse në rast të kundërt ju dëmtohet rëndë shëndeti. Studime të shumta vërtetojnë se mungesa e gjumit shkakton probleme serioze në shëndet. Me raste mund "të vidhni" disa orë nga gjumi, por kjo të mos bëhet zakoni i keq.

8 orët e mëpasshme i kalojmë me punë. Shoqëria dhe jeta jonë është gjithmonë e më komplekse. Kësaj mënyre jetese i bashkangjitet më shumë punë, dhe kjo punë dhe koha e kaluar me të na rrëmben gjithmonë e më shumë gjëra nga jeta jonë.

8 orarshi i tretë është koha e lirë, e cila na tërheq vëmendjen që të mos bëhemi robër të punës. Në jetë ekzistojnë edhe gjëra të tjera përveç punës, dhe duhet t'i kushtojmë kohë edhe këtyre gjërave. Nëse s'e bëjmë këtë sukseset e arritura e humbasin rëndësinë e tyre.

Njerëzit e suksesshëm një pjesë të kohës së tyre ua kushtojnë me vetëdije familjes, qeshin shumë, luajnë me fëmijët e tyre, shplohden, lexojnë, argëtohen, shkojnë në ndeshje, të menduar shikojnë qiellin dhe retë...

Radhita shumë shkaqe me të cilat ju motivoj të përpiqeni çdo ditë për realizimin e



Shfrytëzimi i kohës

Të dashur distributorë të FLP-s, na tregoni se si e shfrytëzoni kohën dhe unë ju them se çfarë keni për të arritur pas 10 vitesh. Jam i sigurt se mund t'ua them.

ndarjes së kohës 3 x 8 orë. Koha e kaluar me punë mbush pjesën më të madhe të kohës, prandaj sot flasim rreth ndarjes së kohës së punës. Pavarësisht nga fakti se si i kalojmë 24 orët, koha s'pret asnjëri, por kalon pa ndalesë.

Tani ju lutem të imagjinoni një bankë e cila çdo mëngjes derdh 86 400 forinta në llogarinë tuaj bankare, por s'mund të mbani asnjë forint për ditën e nesërme dhe nuk mund t'i nxirni dhe t'i ruani në cash. Dhe në fund të çdo dite banka ua merr shumën që s'e shpenzuar. Çfarë do të bënit? Do t'i shpenzonit deri në forintën e fundit? Natyrisht, dhe me shumë kënaqësi!

Të dashur distributor, të gjithë të përgatiten që ekziston një bankë e tillë! Ajo quhet KOHA. Çdo mëngjes në llogarinë tuaj bankare banka me emrin Kohë ju derdh 86 400 sekonda, dhe çdo darkë ua merr nga llogaria pjesën që nuk e shfrytëzuar me zgjuarsi. Këtë nuk mund ta merrni ditën tjetër. Banka çdo ditë hap një llogari të re dhe çdo darkë e mbyll atë. Nëse një ditë nuk arrini ta përdorni këtë shumë, atëherë dilni me humbje. S'ka hap prapa dhe kërkim borxhi nga dita e djeshme. S'ka rezerva për ditën e nesërme – tani duhet jetuar dhe duhet shfrytëzuar koha që i përket ditës së sotme.

Lindin disa pyetje: Si mund ta shfrytëzojmë sa më mirë këtë kohë? Si mund të nxjerrim sa më shumë përfitim nga dita e sotme? Gjithçka ndodh në një ditë. Si ta bëjmë investimin më të mirë të jetës sonë, kur ndërkohë duhet të bëjmë garë me kohën që kalon shumë shpejt?

Nëse dëshironi të keni sukses, filloni ta shfrytëzoni mirë kohën. Ndjenja e shfrytëzimit të mirë të kohës është një pushtet i cili hap derën e lumturisë dhe besimit në vetvete. Është e mundshme

vetëm nëse drejtimin e ndarjes së kohës e keni vetë në dorë. Pavarësisht se sa jeni të prirur ta zgjasni kohën dhe të flisni gjatë për gjëra pa rëndësi, nëse mund ta mbani nën kontroll shfrytëzimin e kohës, atëherë keni për t'u bërë njeri produktiv dhe efektiv.

Njerëzit e suksesshëm dhe të paguar mirë përpiqen ta kryejnë në këtë mënyrë punën e tyre.

Cili është hapi i parë që duhet të bëni me të cilin mund të përvetësoni shkencën e ndarjes së kohës?

Hapi i parë që ju pret është analizimi i pikës së nisjes, gjendjes aktuale ku ndodheni: sa kohë i kushtoni gjërave të ndryshme dhe si e bëni atë. Këtë analizë bëheni pa mëshirë me veten tuaj, sepse rreth jush bën fjalë! Kur njerëzit shtrojnë pyetjen që me çfarë e kalojnë kohën, shumica përgjigjet që me gjëra të rëndësishme, por nxitojnë vazhdimisht dhe janë gjithmonë të pakënaqur me ndarjen e kohës. Dhe kur marrin si këshillë që për disa ditë ta mbajnë shënim ndarjen e kohës, këtë nuk e pranojnë, sepse thonë se dinë ta ndajnë kohën e tyre. Kurse të tjerë janë të sigurtë me vetveten, janë gati të pranojnë këshilla dhe të mbajnë shënim për disa ditë ndarjen e kohës së tyre, nga e cila edhe vetë ata çuditen se sa kohë harxhojnë kot – për gjëra të kota. Pra, njerëzit që janë të sigurtë me vetveten dhe janë të gatshëm ta kryejnë këtë analizë, janë gati për ndryshime dhe ndarjen e duhur të kohës.

Mbaheni mend: ndarja e kohës s'është një ndryshim i aspektit teknik. Në të vërtetë ky është një ndryshim i pikëpamjes së jetës dhe qëndrimit ndaj jetës.

Këtë dëshiroj ta bëj më të qartë, prandaj po e krahasoj me programin e dobësimit:

kur dikush vendos të dobësohet i heq rrobat, ngjitet mbi peshore dhe mat peshën e tij. Ajo që tregon peshorja është gjendja aktuale dhe pika e nisjes. Dhe programi i dobësimit përgatitet në bazë të gjendjes aktuale, pikës së nisjes. Nëse peshorja në fillim të shkurtit tregon 86 kg, kurse në fillim të marsit 96 kg, programi i dobësimit dështon, por nëse në shkurt tregon 86 kg, dhe në mars 83 kg, atëherë dobësimi ka filluar. Në këtë mënyrë duhet përgatitur analiza e gjendjes aktuale kur matet se me çfarë dhe si kalohet koha: Me shikim televizori kalohen 4 orë, me leximin e revistave 1 orë, në kafene 2 orë, dhe për punë në këtë program mbeten vetëm 2 orë? Pra nga gjendja aktuale duhet të përgatitet një program i ndarjes së kohës, i cili ka si qëllim që të paktën 8 orë t'ia kushtoni punës së kryer në programin Forever Living Products.

Për këtë pyetje merrni përgjigje nëse i përcaktoni qëllimet që keni me ndarjen e kohës. Si pikë nisje e ndarjes së kohës përcaktoni qëllimet tuaja. Pa qëllime edhe planifikimi dhe metoda më e mirë e punës nuk të ndihmon. Qëllimet na japin forca të mëdha, sepse na tregojnë drejtimin në punë dhe gjithë jetën tonë. Vetëm ai që i ka përcaktuar qëllimet e tij mund ta shikoj nxitimin e përditshëm dhe mund ta mbajë veten edhe në situatat me stres të madh, sepse mund t'i realizoj lehtë dhe me siguri dëshirat e tij. Prandaj distributorë të dashur, përcaktoni qëllimet tuaja. Qëllimi i përcaktuar sot, nesër mund të bëhet sukses!

Qëllimi pa kufi kohor është diçka bosh, sepse një qëllim i tillë mbetet i pafuqishëm. Qëllimi pa kufi kohor është si fisheku pa barut, prandaj – në rast se nuk i përcaktojmë dot qëllimet dhe kufirin e tyre kohor – është si të gjuajmë

me plumba fallco në punë e në jetë gjithashtu.

Mënyra tjetër e ndarjes së kohës është përcaktimi i prioriteteve. Çdo qëllim përbëhet nga disa detyra. Këto janë detyra komplekse, me rëndësi të ndryshme, mes të cilave disa janë shumë të rëndësishme, kurse të tjerat më pak. Duhet t'i radhisim ato, pra duhet të përcaktojmë prioritetet dhe të bëjmë radhitjen e detyrave sipas rëndësisë. Rëndësinë e çdo detyre e vlerësojmë në bazë të pasojave të mundshme. Sa më shumë pasoja të ketë aq më e madhe është detyra. Njerëzit e suksesshëm me të ardhura të mira gjithë kohën e tyre ia kushtojnë detyrave me prioritet të madh. Të tjerët, njerëzit e pasuksesshëm me të ardhura të vogla gjithë kohën e tyre e humbasin duke u marrë me detyra pa vlerë. Është shumë i rëndësishëm fakti se me çfarë e filloni ditën, çfarë është detyra e dytë, e tretë që kryeni, dhe çfarë është ajo me të cilën s'merreni aspak. E rëndësishme është të kryeni çdo detyrë. Kështu mund ta shfrytëzoni sa më mirë kohën, dhe njëkohësisht kontrolloni edhe vetveten. Në çdo rast kur merreni me atë që ju çon më afër qëllimit, veproni me zgjuarsi. Nga ana tjetër, në çdo rast kur i kushtoni kohë asaj që nuk ju çon afër qëllimit, ky s'është vendim i zgjuar.

Pra mjeti kryesor i ndarjes së kohës është përcaktimi i prioriteteve të cilin e përdorni vazhdimisht si mjet drejtimi të vetvetes.

Tani po ju tregoj shembullin e zotit **Charles Schwab** i cili njëqind vjet më parë ishte pronari i një fabrike çeliku amerikane të njohur. Kërkoj këshillën e disa specialistëve për rritjen e produktivitetit të punës së kryer në fabrikë. U paraqit një specialist me emrin **Ivy Lee** i cili garantoi ta zgjidhte këtë detyrë. **Charles Schwab**-it – si çdo

biznesmen tjetër – në radhë të parë i interesonte se sa do i kushtonte kjo. **Ivy Lee** ju përgjigj që asgjë, nëse dështon – por nëse pas 90 ditësh arrin rezultat, t'i paguajë aq sa e vlerëson këtë sukses. **Ivy Lee** donte të fliste personalisht dhjetë minuta me gjithë menaxherët e fabrikës. Gjatë këtyre dhjetë minutave u kërkoi të gjithëve që në fund të ditës të përcaktojnë dhe të mbajnë shënim punët që duhet të kryejnë të nesërmen dhe t'i radhisin ato sipas rëndësisë. Dhe të nesërmen ta filloj ditën e punës me të parën, ta vazhdoj me të dytën e kështu me radhe, nëse s'i mbaron dot të gjitha, pjesën e mbetur ta vazhdoj ditën tjetër. Çdo menaxher u habit dhe s'i besohej që vetëm kaq kërkoi prej tyre. **Ivy Lee** i qetësoi që kjo është e mjaftueshme. Pas 90 ditësh prodhimtaria e fabrikës së çelikut u rrit në mënyrë të konsiderueshme. **Charles Schwab**, biznesmeni i njohur tha se kjo ishte këshilla më e madhe që kishte marrë në jetë, dhe i dha **Ivy Lee**-s një çek 25 000 dollarësh. Për të matur vlerën e çekut duhet të kemi parasysh se njëqind vjet më parë në Amerikë paga ditore ishte 2 dollar.

Mënyra e tretë e shfrytëzimit të kohës është përdorimi i parimit Pareto „80:20”. Pareto ishte një ekonomist italian i cili vuri re se 80% e gjërave të prodhuara shkojnë tek 20% e shoqërisë. Parimi Pareto bën fjalë edhe rreth faktit që realizimit të sfidave më të mëdha u kushtojmë vetëm 20% të kohës. Kolegë të dashur, lind pyetja që çfarë bëhet me 80%-ëshin e mbetur të kohës sonë. Sikur diçka apo dikush na e vjedh kohën. Asnjëri s'na e vjedh, por disa njerëz kryejnë detyra me vlerë të vogël. Ta kini parasysh këtë rregull. Bëhuni specialistë të vërtetë në punën tuaj, sepse kjo është shumë e rëndësishme në kryerjen e punës me vlerë që sjell rezultate të mira.

Mënyra e katërt e shfrytëzimit të mirë të kohës është disiplina personale. Çdo orë, pa pushim bëjini pyetjen vetes: “Tani po e kaloj kohën në mënyrën më të dobishme?” Kur të merrni përgjigje përforcuese nga kjo pyetje, atëherë keni arritur në fazën kur merrni me të vërtetë vetëm me detyrat që ju çojnë drejt realizimit të suksesit. Dhe tani arrini me siguri suksese dyherë, treherë më të mëdha se të tjerët, sepse kryeni punën më të rëndësishme dhe më thelbësore.

Kolegë të dashur! Nëse deri tani s'keni mësuar të thoni **jo**, erdhi koha ta bëni këtë. Thoni me vendosmëri që jo, dhe përgjigjuni me “jo” gjithë kërkesave që ju detyrojnë ta kaloni kohën në mënyrë të pavlerë. Bie telefoni, sepse shoqja juaj kërkon të bisedoj me ju. Jo! Komshiu të thirri sepse do të tregoj kafshën e re shtëpiake që ka marrë. I thoni jo! Dhe kështu me radhë. Shumëherë e humbasim kot kohën tonë, sepse nuk e përdorim fjalën **jo**.

Dueni dhe shijojeni punën tuaj. Me këtë arrini me siguri që të merreni vetëm me detyrat primare dhe mund t'i kushtoni mjaft kohë punës suaj. Dëshiroj ta bëj më të qartë atë që dua të them, prandaj po tregoj tre tregime që bëjnë fjalë rreth vlerës së kohës.

Rreth vlerës së një **viti** pyesni një student i cili duhet të përsëris vitin. Rreth vlerës së një **muaji** pyesni një femër e cila ka bërë lindje shtatanike. Rreth vlerës së një **jave** pyesni redaktorin e një reviste javore.



Rreth vlerës së një **dite** pyesni një njeri i cili punon me pagë ditore, dhe me atë ushqen fëmijët. Rreth vlerës së një **ore** pyesni një çift të dashuruar të cilët mezi presin të takohen përsëri me njëri tjetrin. Rreth vlerës së një **minute** pyesni atë që s'e arriti dot nisjen e trenit, autobusit apo avionit. Vlerën e **sekondës** mund ta shpjegoj më mirë ai që ka mbijetuar një aksident të rëndë. Rreth vlerës së **të dhjetës së sekondës** mund të flas më mirë një fitues i medaljes së argjendit në lojrat olimpike.

Një farë **William Sidney Porter** ulur njëherë në burg po mendohej se çfarë marrëzie bëri që vodhi. Por për një gjë ishte i sigurt: në këtë mënyrë fitoi shumë kohë të lirë. Dhe e shfytëzoi me sukses këtë mundësi. Filloi të shkruaj tregime të vogla të cilat ua shiti revistave nën emrin artistik **O'Henry**. Kur e mbaroi dënimin e tij, nga burgu kaloi në rrugën e suksesit. E kuptoi se jeta ka vlerë vetëm nëse ecën në rrugën e suksesit dhe e ndan kohën e vet.

Letra që një grua i shkroi burrit të saj informaticien: "Burri im i dashur! Po ta shkruaj këtë letër në një zarf të firmës së prodhimit të kompjuterave, sepse dua të jem e sigurt që do e lexosh. Të lutem, më fal për këtë tradhëti, por do doja të dije se çfarë ndodhi në shtëpinë tonë gjatë dy viteve të kaluara, që kur bleve kompjuterin. Fëmijët janë shumë mirë. Marko është shtatë vjeç dhe vizaton familjen. Do të ishte shumë krenar po ta shikoje se si të

ka vizatuar. Karrigia dhe pjesa e prapme e kokës tënde janë shumë realiste. Maja në korrik mbushi tre vjeç. Është akoma shumë e lumtur që ishe me të kur kishte ditëlindjen. Thotë se ajo ishte dita më e bukur e jetës së saj pavarësisht nga fakti se jashtë binte shi dhe nuk kishte drita. Edhe unë mirë jam. Vitin e kaluar i bëra flokët bjonde. Shefi im kujdeset për karrierën time dhe është bërë një mik i vërtetë i familjes. Kur morra vesh se ty s'të shqetëson po të fshij rreth karriges tënde, që atëherë e kam më të lehtë për të bërë punët e shtëpisë. Shtëpia duket mirë. S'jam e sigurt që e ke vënë re: vjet në pranverë leva muret. I dashur, tani duhet të bëj valixhet gati. Shefi im do na çoj për të bërë ski. Morra një pastruese që të kujdeset për ty dhe për shtëpinë derisa të kthehemi. Të bën kafe dhe ta shtron drekën ashtu siç e dëshiron ti. Shpresoj që ti dhe kompjuteri yt do e ndjeni mirë veten përsa kohë që s'jemi me ty. Marko, Maja dhe unë mendojmë shumë për ty. Shpresoj që të mendosh për ne të paktën kur e nderz përsëri kompjuterin. Me dashuri, gruaja jote." Kolegë të dashur, mos lejoni që edhe jeta juaj të bëhet e tillë. Koha juaj të qëndëroj në ekuilibër.

Shumë gjëra mund të sjellin sukses, por atë asnjëri s'e arrin dot brenda një dite. Pavarësisht nga fakti që efekti i mirë i suksesit mund të ndihet shpejt, njerëzit me të vërtetë të suksesshëm pjesën më të madhe të kohës ia kushtojnë realizimit të dëshirave të tyre. Kolegë të dashur, shpresoj që ju motivova për ndarje më të mirë kohe, për efektivitet dhe produktivitet më të madh.



IN MEMORIAM
CVETKO RATKOVIĆ
safir menaxher
(1943-2008)

Forever jep me bujari

E falenderojmë shumë drejtorin gjeneral Dr. Sandor Milesz për mundësinë e dhënë për organizimin e takimit të parë të menaxherëve të FLP Serbisë.



Aktiviteti ynë i paharruar plot me punë e miqësi u organizua në ambientin e mrekullueshëm të hotelit President të Bogradit. Mund të themi me të drejtë se ambienti ishte i denjë për menaxherët e FLP-s, sepse po në këtë vend mbahen edhe takimet e Komisionit Serb të Olimpiadës. Gjithçka ishte pro nesh: koha e mrekullueshme, ambienti i këndshëm, punonjësit me humor të mirë dhe personeli i dashur i hotelit që na i plotësoi gjithë dëshirat.

Menaxherët u përshëndetën nga drejtori rajonal i FLP Serbisë **Branislav Rajić**.

Ai tha që menaxherët e FLP-s e kanë treguar se me lojalitet, besim në vetvete dhe njerëzit që jetojnë rreth tyre, me punë të vullnetshme e të ndershme mund ta bëjnë më cilësore e më të bukur jetën. Ta shfrytëzojmë këtë mundësi, dhe t'ua ofrojmë edhe të tjerëve shansin që ne na u dha dikur! Kjo „imtësi“ s'është gjë tjetër veçse anëtarësia e FLP-s e cila ndryshon jetën e të gjithëve.

U gëzuam shumë që na erdhën si mysafirë fituesit e Programit Motivues 1 + 5. Bashkë me punonjësit menaxher u shpërblyen

me pjesëmarrjen në një statut të veçantë në programin e këtij takimi.

Na u bë një nder i madh sepse drejtori Operativ i FLP-s së Europës **Peter Lenkey** ndau me ne idetë dhe vizionet e tij. Mysafiri ynë i respektuar na siguroi rreth dashurisë dhe besimit të **Rex-it**, **Gregg**-ut dhe **Aidan**-it. Na tregoi se kemi përparësi të madhe, sepse punojmë në një kompani e cila ndryshon shumë nga të tjerat, sepse Forever jep me bujari, kurse kompanitë e tjara kryesisht marrin nga punonjësit e tyre. Vizioni fisnik i Rex-it rreth një

jete më të bukur mund të arrihet prej secilit prej nesh me veprimtarinë e kryer në radhët e FLP-s. Falenderojmë zotin Lenkey për kohën e kaluar me ne dhe kryesisht për faktin që – sipas fjalëve të tij – mes nesh e ndjen veten si në shtëpinë e vet.

Menaxherja drejtuese e FLP Serbisë **Veronika Lomjanski** bëri të ditur për të gjithë se niveli i menaxherit në kompaninë tonë është vetëm një shkallë kualifikimi momentale, prandaj duhet ta vazhdojmë me të njëjtat forca dhe ritëm punën që na çoi drejt arritjes së nivelit të



menaxherit. Detyra jonë është që t'u ofrojmë sa më shumë njerëzve që jetojnë përreth nesh të gjitha mundësitë që ofron FLP-ja: duke filluar që nga bonusat bazë (të drejtat e autorit) deri tek programet e shumta motivuese, sepse këto të shpërblejnë në mënyrë të shumfishtë për të njëjtën punë të kryer. Rex na ofron mundësi të shumta, vetëm duhet t'i shfrytëzojmë ato.



Pas leksioneve menaxherët marrën pjesë në disa aktivitete sportive. Gjuajta e pëllumbit prej balte u pëlqye shumë nga të gjithë dhe e ngriti edhe më shumë shpirtin e garës gjithmonë tepër të gjallë të punojësve drejtues të Forever-it të Serbisë. Shpresojmë që edhe në të ardhmen të takohemi në një ambient po kaq të bukur dhe në një numër edhe më të madh. Falenderojmë menaxherët tanë për ndihmën e dhënë në organizimin dhe realizimin e takimit tonë të mrekullueshëm.

BRANISLAV RAJIĆ
Drejtori rajonal i FLP Serbisë

“Atë që mendja e beson, njeriu edhe e realizon” (Napoleon Hill)



U mendova shumë që çfarë të shkruaja, pasi dëshiroj të të ofroj diçka me të cilën mund të ndihmoj punën tënde në FLP. Ndoshta gjithë artikulli do të ketë vetëm një fjalë ose një fjali që të përket ty, dhe në këtë rast ia vlente të merrja penën në dorë.

Mendimet e mia rreth FLP-s

Përhëndetje Lexues i dashur, Mik i dashur!

Mendoj se keni dëgjuar shumë rreth mundësisë së biznesit FLP, ëndrrave, qëllimeve dhe hapave në praktikë nga rrjetndërtues njëri më i mirë se tjetri. Kurse rreth efektit të përbërësve të produkteve keni mësuar nga mjek fantastik dhe përvojat personale.

Unë dëshiroj t'ju jap ndjenja dhe besim, të cilat u formuan brenda meje gjatë këtyre 11 viteve që njoh kompaninë Forever Living Products dhe **Rex Maughan**.

Shëndet, Miqësi, Dashuri, Buzëqeshje, Harmoni, Entuziazëm, Siguri, Argëtim, Udhëtim, Vlerësim, Sukses, Formë Jetese, Pavarësi..... dhe përveç këtyre një mjet, **Paranë!**

Rreth këtyre tregoj kur i flas dikujt rreth mundësive të dhëna nga FLP.

Mund të vendos se çfarë dëshiron të marrë prej këtyre?

Kur 11 vjet më parë dëgjova rreth këtyre nga **Dr. Endre Nemeth** më erdhi një mendim: "nëse vetëm gjysma e kësaj është e vërtetë, edhe kjo është e mjaftueshme". Atëherë në rrethanat e mia të jetës kjo mundësi ishte një rreze drite të cilën m'u duk se duhet ta ndiqja!

Duhet të ndiqja sponsorët e mi, Endre-n dhe gruan e tij Agi Lukacs-in, dhe duhet të ndiqja moton që Rex përfaqëson deri më sot: "**Ndihmo të tjerët dhe nëpërmjet kësaj ndihmon edhe vetveten**".

Sot është akoma më i vërtetë mendimi i Rex-it, pasi po të shikojmë në botë kudo mendja e njerëzve është e ngarkuar me gjëra negative. E di që është e vështirë të shkosh tek njerëzit në këtë situatë, madje edhe plot entuziazëm, pasi të refuzojnë menjëherë, por mendoj dhe besoj se ka njerëz të cilët nuk ankohen, por kërkojnë rrugëzgjdhje për shëndetin dhe ndryshimin e jetës së tyre.

Mund të themi se presin që diçka/dikush t' kërkoj ata ☺

Këta njerëz duan TË JETOJNË – Ata kërko!

Mos harxho shumë kohë me njerëz të cilët duan vetëm të ankohen, të qahen, dhe nuk duan të dëgjojnë zgjidhjet për hallet e tyre.

Unë kam provuar shumë gjëra fantastike me FLP-n, dhe më duket se e kam për detyrë ta përcjell mëtej këtë, pasi përfaqësoj një çështje fantastike. Nëse edhe Ti kështu mendon, atëherë njerëzit do të kenë besim tek ty dhe kanë për ta pranuar ndihmën tënde.

Ndërto me pasion dhe zjarr biznesin tënd!

Siguro njohuri, përcilli me kënaqësi informacionet rreth produkteve, pasi ato janë të mrekullueshme. Bëji të suksesshëm njerëzit me mundësinë e shkëlqyer të biznesit që ofrojnë sfidat dhe sistemi i shpërblimit të FLP-s. Sill lumturi në jetën familjare.

Ndjenja, ndjenja, ndjenja!

Ky biznes nuk mund të bëhet si robot, nuk mund të ndërtohet pa ndjenja, pasi një nga elementet kryesore të tij është **DASHURIA** e cila ne, anëtarët e FLP-s, na **BASHKON** pavarësisht nga çdo gjë negative!

Jam krenare që skuadra ime e pranon prej meje dhe e ndjek këtë moto.

Jam e lumtur që dy familje që më përkasim mua në mënyrë të drejtpërdrejtë morrën pavarësinë njerëzore dhe materiale që ofron niveli i menaxherit, dhe do përpiqem që këtë ta arrijnë edhe punonjësit e tjerë të mi.

Unë e përfaqësoj në mënyrë të palodhur moton e Rex-it!

U uroj të gjithëve një punë me rezultat!



MAGDI KOVACSNE
Menaxhere

Pavarësia e punës

Në perlën magjepse turistike të Serbisë kaluam një fundjavë të paharrueshme me distributorët drejtues të FLP Serbisë. Jemi të sigurt se energjinë e çliruar dhe efektin e mjedisit të mrekullueshëm malor do ta shfrytëzojmë sa më mirë për funksionimin edhe më me sukses të kompanisë dhe ndërtimit të rrjetit.



Lektorët e seminarit ishin: **Dr. Sandor Milesz**, drejtori rajonal i Hungarisë dhe i rajonit Sllavo-jugor, dhe anëtarët e Forever President's Club të Serbisë.

Drejtuasi i aktivitetit ishte drejtori rajonal i FLP Serbisë, menaxheri **Branislav Rajić**. Zoti Rajić theksoi që puna në skuadër është metoda më e mirë e punës dhe takimet e këtij lloji kontribuojnë në përparimin e rrjetndërtuesve të kompanisë sonë. Edhe vitin e ardhshëm i presim

të gjithë me kënaqësi, shpresojmë të vini në një nmër akoma më të madh.

Kushti bazë i formimit të menaxherëve të vërtetë dhe karrierës së suksesshme në FLP është puna e përditshme e planifikuar, si dhe krijimi i personalitetit dhe aftësisë së menaxhimit. **Dr. Sandor Milesz**, drejtori gjeneral më i mirë dhe më efektiv i botës, në leksionin e tij tha se rrjeti marketing – përveç pavarësisë në punë – të ofron edhe përdorim të lirë kohe, dhe kjo është shumë





e rëndësishme. Burimin e forcës të nevojshme për punën tonë duhet ta gjejmë tek punonjësit e rinj dhe rinia, e cila duhet ta njoh me çdo kusht Forever-in.

Marija Nakić është shembull i shkëlqyer i faktit se si mund të bëhet nga një pensioniste punonjëse dhe drejtuese e shkëlqyer rrjeti. Kohën e saj ia kushton plotësisht fëmijëve, nipërve dhe mbesave të saj, por përveç kësaj pushtohet edhe nga një ndjenjë e mrekullueshme, sepse ndërkohë është edhe pjesëtare aktive dhe e dobishme e shoqërisë. E falenderojmë Marija-n për energjinë dhe besnikërinë e dëshmuar ndaj kompanisë sonë.

Soaring menaxherja **Dragana Janović** shpjegoi se "si mendojnë milionerët". Njerëzit e suksesshëm përipiqen gjithmonë për realizimin e planeve të mëdha dhe pikësynimeve të larta, dhe zotërojnë një vizion të qartë pune. Ata në interes të përparimit ia kushtojnë kohën mësimi të vazhdueshëm dhe janë në mënyrë maksimale besnik ndaj firmës që përfaqësojnë.

Si të përparojmë mëtej kur – pavarësisht nga fakti që plani Marketing u përket njëllor të gjithëve – disa njerëz janë gjithmonë shumë të suksesshëm, kurse të tjerë kanë vazhdimisht probleme gjatë punës së tyre? Kësaj pyetje shumë të rëndësishme i dha përgjigjen e duhur diamant menaxheri **Stevan Lomjanski**. Kriteret e karrierës së suksesshme në FLP janë: guximi i gjithë punonjësve, lojaliteti ndaj firmës, marrja e vendimit të duhur, shpirti fitimtar, ndjenja e drejtësisë dhe përgjegjësia personale!

Ritmi i punës dhe freskia e soaring menaxherit **Miloš Janović** s'ka rënë që nga dita e parë. Puna e kryer me pasion na motivon për zhvillim të mëtejshëm i cili s'ka të bëjë vetëm me punën,







por edhe me çështjet e tjera të rëndësishme të jetës.

Safir menaxheri **Buruš Boško** u thotë të gjithëve që të lemë mënjanë egon tonë, të ndryshojmë, të përcaktojmë pikësynimet në kuadrin e të cilave duam të ndryshojmë. Puna e kryer në këtë mënyrë i sjell sukses gjithë skuadrës nëse i kushtojmë përkushtimin e duhur realizimit të programeve motivuese.

“Dimë gjithçka, na mbetet prapa vetëm të punojmë!” – tha në leksionin e saj safir menaxherja **Marija Buruš**. Nëse njëherë ke arritur realizimin e 120 pikëve në dy muaj që vijnë njëri pas tjetrit, atëherë përse të mos e përsërisish këtë vazhdimisht? Ta shfrytëzojmë mundësinë që me realizimin e programeve motivuese të ndërtojmë shpirtin e skuadrës, pasi Rex ka siguruar që këtë ta arrijmë edhe bashkë me mundësitë „e rregullta! Puna e kryer me dëshirë siguron entuziazëm, energji të reja dhe rezultat të shkëlqyer.

Në këtë moment ofrojmë shumë dhe punojmë shumë mirë. Marrim prapa aq sa japim në këtë punë. Duhet të vendosim që a do e bëjmë këtë përparim të madh në punë. Do të fitojmë me siguri! Nuk mund të rrëzohemi, sepse këtë s’na e lejon Plani Marketing i FLP-s. Ia dimë për nder diamant menaxheres **Veronika Lomjanski**, e cila e përhap me kënaqësi vizionin e punës FLP në Serbi dhe gjithë Europën.

Takohemi vitin e ardhshëm në një numër akoma më të madh!

Vetëm bashkëpunimi me punonjësit e rinj, besimi në vetvete, puna në skuadër e kryer me entuziazëm dhe vlerësimi i sponsorit të çon drejt sukseseve të mëtëjshme!

BRANISLAV RAJIĆ
Drejtori rajonal i FLP Serbisë

Një paradite të shtune plot me rreze dielli në Lubjanë

Në një paradite të shtune plot me rreze dielli u mbledhëm në një takim të këndshëm për të mësuar në Lubjanë. Vera ka trokitur fortë në dyer, kështu që këngëtarët e rinj të grupit **Foxy Teens** krijuan një atmosferë të vërtetë verore në skenë, me këngët e tyre u zgjuam plotësisht dhe ishim gati të dëgjonim leksionet interesante që distributorët tanë kishin përgatitur për ne.

Përsëritet me duart rokitje të madhe anëtarin e organizatës sonë, masazhatoren dhe mjeshtren e kozmetikës **Špela Salobir**, e cila prezantoi produktet e kompletit Body Toning Kit, foli rreth bazave të ushqimit të shëndetshëm, si dhe si të përdorim programet e përgatitur me kujdes Clean 9, Lifestyle 30 dhe Nutri-Lean TM përdorimi i duhur i të cilave ndikon në arritjen e peshës ideale të trupit dhe gjendjes së mirë shpirtërore.

Të mbledhurit u përshëndetën nga drejtori rajonal **Andrej Kepe**, i cili shpalli programin e Holiday Rally-t të Poreçit, dhe kërkoi nga të gjithë që të motivojnë distributorët e rinj për plotësimin e programit dhe të bashkohen me ne në një takim të ri të paharrueshëm në tetor, në Poreç! Prezantoi të gjitha programet e tjera motivuese, dhe tha me kënaqësi që edhe në Trzin u hap një sallon Sonya. Ftojme gjithë distributorët që



të vijnë, ta lenë veten në duart e masazhatores dhe mjeshtres sonë të kozmetikës, kurse ajo do t'i trajtojë ata me produktet Sonya dhe produkte të tjera Forever. Në sallon mund të gjenden edhe kupona dhuratash.

Edhe senior menaxherja **Jožica Zore** e di mirë se një nga kriteret bazë të suksesit

të arritur edhe nga ajo në ndërtimin e rrjetit është gjendja e mirë shpirtërore. Ajo plotësoi kushtet e programit World Rally dhe së bashku me distributorët më të suksesshëm të rajonit tonë ishte në Afrikën e Jugut. Me tregimin e këtij udhëtimi na bëri për vete, të gjithë pa përjashtim do të kishim dëshirë ta përjetonim mikpritjen e **Rex**

Maughan, pasi distributorëve më të suksesshëm ai u siguron gjithmonë mbresa të paharrueshme. Falenderojmë Jožica-n që ndau me ne mbresat dhe ndjenjat e saj, i urojmë të marrë pjesë në sa më shumë shpërblime të tilla. Të gjithë atyre që punuan me vullnet gjatë muajve të kaluar u dhamë shiritin e kualifikimit

në **Klubin e Sundimtarëve**. I përgëzojmë sundimtarët për sukseset e arritura!

Në vazhdim u argëtuam përsëri me këngët e grupit Foxy Teens, pastaj ata u ndoqën në skenë nga menaxherja **Danica Bigec**, e cila si fizioterapiste me emër ndodhet prej vitesh në botën e Forever-it. Tregoi procesin e krijimit të plagëve



nga dëmtimet e ndryshme, ku produktet tona ofrojnë ndihmë të shkëlqyer. E falenderojmë për leksionin e shkëlqyer dhe atmosferën e mirë, i urojmë asaj suksese të mëtejshme në kombinimin e fizioterapisë me Forever-in!

Përpara nesh doli përsëri Špela Solobir e cila tek një

zonjë të zgjedhur nga publiku tregoi se si mund ta pastrojmë rrënjësisht lëkurën tonë me kompletin Sonya të përzierë me çaj të bardhë. Pastrimi dhe trajtimi i fytyrës përbëhet nga pesë hapa, të cilat duhet t'i bëjmë deri në fund nëse dëshirojmë një lëkurë fytyre të bukur e të shëndetshme.

E falenderojmë Špela-n për të dy leksionet! Si përfundim në skenë thirrëm ata që në të ardhmen do e ngrënë lart flamurin e Forever-it për t'u dhënë tani me kënaqësi medaljen e shqiptonjës. Distributorë të dashur, dëshiroj t'ju kujtoj edhe njëherë që në zyrën e Trzinit në rastin e blerjes së

Touch dhe Body Toning Kit (të dy produktet), si dhe kompletit Aroma Spa dhe Sonya Skin Care (të dy produktet), ju dhurojmë kupona dhuratash që mund të përdoren për masazh fytyre dhe shpine në sallonin Sonya.

ANDREJ KEPE

Drejtori rajonal i FLP Sllovenisë

★★★★★
Hotel Kastély
 SZIRÁK



Të dashur Mysafir të Rinj e të Vjetër!

